



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 316/11 Prot

Elbasan më 27/01/2020

**VENDIM**

Nr. 2 datë 27/01/2020

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin JANAR 2020**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 6 datë 24.01.2019 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

**V E N D O S I**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **JANAR 2020** gjithsej 160 familje me një fond prej 400.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak  
Hektor Çiftja





*[Handwritten signature]*



3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 317/11 Prot

Elbasan më 27/01/2020

**VENDIM**

Nr. 15 datë 27/01/2020.

**Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë, për muajin  
JANAR 2020**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 5 datë 24.01.2019 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

**VENDOSI**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin JANAR 90 familje me fond 270.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak  
Hektor Çiftja



38





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN**

Nr 329 prot  
11

Elbasan më 27/01 2020

**VENDIM**  
Nr 3 datë 27/01/2020

**Mbi miratimin e kritereve të dhënies së Ndhmës Ekonomike nga fondi i Bashkise**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” në pikën 3 të kreut IV të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike”

Këshilli Bashkiak:

**VENDOSI**

- I. Të miratojë kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë si më poshtë:
  1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit,
  2. Familje shumë të varfëra që për shkaqe sociale nuk arrijnë të aplikojnë sipas VKM nr.955 datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”
  3. Familje të varfëra me një bashkëshort të larguar(apo në burg) dhe që nuk mund të fillojnë procedurat e divorcit, apo nuk sigurojnë dokumentat përkatës.
  4. Familje me probleme të tjera sociale.
- II. Dokumentat e aplikuesve të jenë: Çertifikatë familjare, Fotokopje e kartës së identitetit, Vërtetime nga Adm.Njesisë a PSZ dhe formulari i paraqitjes mujore.
- III. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr. 955 date 7.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” dhe Udhezimit nr. 4 datë 17.02.2017 “Për përlllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”, për numrin faktik të anëtarëve të familjes.

10

3

- IV. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar si dhe Drejtoria e Financës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

**Sekretari Këshillit Bashkiak**

**Klajd GRIPSHI**

**Kryetari I Këshillit Bashkiak**

**Hektor Çiftja**



100

100



Handwritten signature or initials in blue ink.



2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 3257 Prot  
11

Elbasan më 27/01/2020

**VENDIM**  
Nr. 4 datë 27/01/2020

**Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike**

KËSHILLIT BASHKIAK

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_/01/2019 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” në pikën 1,2,3 të kreut IV të VKM nr. 597,datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike”; pika 4 e udhëzimit nr. 5 datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%” të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë:

**VENDOSI**

- I. Të miratojë kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si më poshtë:
  - 1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit,
  - 2. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale,
  - 3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune,
  - 4. Familje me shumë fëmijë
  - 5. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë antarë që ndjekin universitetin;
  - 6. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me paaftësi/invalidë pune;
- II. Dokumentat e aplikuesve të jenë të njëjta me VKM nr. 955 datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”;

10

10

10

10

10

10

10

10

10

3

- III. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr. 955 date 7.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” dhe Udhezimit nr. 4 datë 17.02.2017 “Për përlogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”.
- IV. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar si dhe Drejtoria e Financës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

**Sekretari Këshillit Bashkiak**

**Klajd GRIPSHI**

**Kryetari I Këshillit Bashkiak**

**Hektor Çiftja**



100-100



100-100

*[Handwritten signature]*



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 359 / Prot.

Elbasan më 31.01.2020

V E N D I M

115 PËR dt. 27.01.2020

"STUDIMIN DHE RIORGANIZIMIN E TRANSPORTIT PUBLIK URBAN"  
PËR BASHKINË E MADHE.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës \_\_.\_\_.2020, pasi shqyrtoi materialin dhe propozimin e grupit të punës ngritur me urdhër nr. 842 datë 03.09.2019 "Për ngritjen e grupit të punës, që do të hartoj studimin për riorganizimin e linjave të transportit publik urban në Bashkinë Elbasan", bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin 8308 date 18.03.1998 "Për transportet rrugore" i ndryshuar, udhëzim nr. 5627, datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit" i ndryshuar, ligjin nr.8378, datë 22.07.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, VKM nr.1096, datë 28.12.2015 "Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike" udhëzim nr. 446, datë 10.5.2018 "Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve".

VENDOSI

Të miratoj:

1. Rishikimin e rrjetit të linjave të transportit publik qytetës (urban) sipas tabelës bashkëngjitur;
2. Hapja e rrugës për në varreza me kalim mbi linjën hekurudhore (tek rruga e pallateve të ish kinezeve tek pedagogjikja); dhe linja e varezave publike egzistuese të ndryshoj intinerarin.
3. Hapja e bllokimit të rrugës tek kryqezimi Alfa bank
4. Ndërtimi i një mbikalimi (ose nënkalimi) për këmbësoret tek stacioni i autobusëve të urbanit në rrugën Qemal Stafa ( miratim në parim);
5. Rikonstruksioni i segmenteve rrugore në lagjen tek ish parku dhe në segmentin rrugor Hermes- drejt Inceratorit(miratim në parim);



74

6. Heqja e ndalimit te automjeteve ne segmentin rrugor nga Rrethrotullimi i Bashkisë deri tek shkolla Pedagogjike dhe te vendoset sinjalistika perkatese. Gjithashtu te behen xhepa per stacionin e autobuzave urban dhe per kazanin e mbeturinave, ne kete segment.
7. Në Bulevardin "Aqif Pasha" në segmentin nga Stadiumi tek rrethrotullimi I Majit; te behet parkim me pagese.
8. Rishikimi i rrethrotullimit tek I Maji (miratim në parim);
9. Ne aksin rrugor PTT- Kryqëzimi i Luleve (Rruga Qemal Stafa), te hapet trafikndaresi, tek kryqëzimi me rrugën A.Frasherit, pasi shkarkohet trafiku ne raste emergjence midis dy rrugeve A.Pasha dhe Q.Stafa dhe lehtesohet trafiku te shkolla J.Dilo, para mbarimit te rikonstruksionit te shkolles J.Dilo.
10. Te behet sa me shpejt Studimi i Planit Urban te Trafikut dhe Sinjalistikës (PUT&S) (miratim në parim)
11. Të bëhet një korsi vajtje-ardhje për biçikletat në aksin Parku Rinia-Bulevardi A.Pasha - Ura Zaranikes;
12. Të bëhet një korsi për biçikletat në aksin Banesa-Ura e Shkumbinit (miratim në parim);
13. Të bëhet një korsi për biçikletat në aksin Sheshi tek Zaranika- Bulevardi Qendror-Krastë (miratim në parim);
14. Të ndërmerren hapat e nevojshme për ndërtimin e Terminalit Multimodal sipas studimit te fizibilitetit të kryer nga USAID;
15. Ndërtimi i konstruksioneve te Stacioneve te qëndrimit te udhëtareve dhe pajisja me sinjalistika vertikale aty ku mungon;
16. Të behen vendet e qëndrim të taksive si dhe vijëzimi dhe vendosja e tabelave të stacioneve te qëndrimit te mjeteve taksit 8+1 dhe 4+1; sipas studimit.
17. Vendosja e sistemit të informacionit me oraret, ( nga operatorët).
18. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

SEK. K. BASHKIAK

Klajdi Gripshi

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Hektor Ciftja



1  
2  
3  
4



27

*[Faint handwritten text, possibly a signature or date]*





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M  
Nr. 6 datë 27.01.2020

dt. 31.01.2020

Hu 314/ Pref.

“Për

**Miratimin e normave dhe kritere për disiplinimin e shpenzimeve për mjetet motorike në administrim të "Agjensisë së Shërbimeve Publike Elbasan" per vitin 2020**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, të ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Këshilli i Bashkisë Elbasan, pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga Agjencia e Shërbimeve Publike Elbasan, në mbledhjen e tij të datës 27.01.2020

**VENDOSI:**

1. Të miratojë normativat e konsumit të karburantit për mjetet motorike në administrim të "Agjensisë së Shërbimeve Publike Elbasan", per vitin 2020 sipas tabelës bashkëngjitur .
2. Agjencia e Shërbimeve Publike Elbasan ka të drejtën dhe përgjegjësinë për të marrë të gjitha masat për kontrollin dhe evidencimin e të gjitha lëvizjeve dhe orëve të punës të automjeteve, me qëllim mirëmenaxhimin e konsumit të karburantit, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.
3. Agjencia e Shërbimeve Publike Elbasan ka të drejtën dhe përgjegjësinë për përballimin me fonde të buxhetit vendor të njësisë shpenzuese, të të gjitha shpenzimeve për karburant, pjesë këmbimi dhe të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera ligjore (kolaudimin, siguracionin, etj) për përdorimin normal të mjeteve motorike, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.
4. Ngarkohet Drejtori i Agjensisë së Shërbimeve Publike Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

**KËSHILLI I BASHKISË ELBASAN**

**SEKRETAR**  
Klajdi GRIPSHI



**KRYETAR**  
Hektor Çiftja



Handwritten text in blue ink, appearing to be a signature or initials.

Handwritten text in blue ink, appearing to be a signature or initials.



5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 322 Prot.

Elbasan, më 31.01.2020

V E N D I M

Nr. 7 Datë: 27.01.2020

*“Mbi miratimin e fillimit të procedurave për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, të sipërfaqes ndodhur në Z.K. 2355, Nj.Administrative Labinot-Fushë”.*

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_ .01.2020, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës (Sektori i Pronave), *“Mbi miratimin e fillimit të procedurave për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, të sipërfaqes ndodhur në Z.K. 2355, Nj.Administrative Labinot-Fushë”*, bazuar në ligjin Nr.139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*;

V E N D O S I:

1. Miraton fillimin e procedurave për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, me qëllim zhvillimin ekonomik e social të qytetit të Elbasanit për kryerjen e investimeve në fushën e bujqësisë dhe industrisë, të një sipërfaqe totale prej 18493 m<sup>2</sup>, ndodhur në Njësinë Administrative Labinot – Fushë, Z.K. 2355, me Indeks harte K-34-101(150-A); K-34-101(149-B), (bashkëlidhur planvendosjet).
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Operacionale, Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës (Sektori i Pronave), Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI  
Klajd Gripshi



KRYETARI  
Hektor Çiftja



1911

1911

1911

1911

1911

1911

1911

1911


1911

1911

1911

1911

1911



1911



1911



3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 319/11 Prot.

Elbasan, më 31.01.2020

VENDIM

Nr. 9 Datë : 27.01.2020

**“Mbyllje procedure privatizimi banese shtetërore”**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_ pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve, Buxhetit dhe Financës, (Sektori i Strehimit, Privatizimit), mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Dekretin e Presidentit të Republikës Nr.1440 datë 04.04.1996 “Për trajtimin e banesave shtetërore të paprivatizuara”, Ligji Nr. 22/2018 “Per Strehim Social”, VKM nr.97 datë 03.02.2008 “ Për procedurat e privatizimit të banesave ”, objekt i ligjit nr.7652 date 23.12.1992 “ Për privatizimin e banesave shtetërore ”, si dhe ligji nr.9321, datë 25.11.2004 “ Për privatizimin e banesave shtetërore dhe objekteve, të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore ” .

**VENDOSI:**

- 1) Miraton **“Mbyllje procedure privatizimi banese shtetërore”** për qytetarët e mëposhtëm:
  - **Trashëgimtarët e Z. Ismail Ramazan Ramazani dhe personat e tjerë madhore sipas çertifikatës të gjëndjes familjare 01.12.1992**, për privatizimin e apartamentit të përbërë nga një dhomë dhe një kuzhinë, të ndodhur në lagjen “ Brigada 17 Sulmuese ”, Rruga “Mahmut Maçi”, banesë e ulët pranë pallatit 107, zona kadastrale 8522, Elbasan.
  - **Qytetari Qazim Riza Çekrezi dhe personat e tjerë madhore sipas çertifikatës të gjëndjes familjare 01.12.1992**, për privatizimin e apartamentit të përbërë nga një dhomë dhe një kuzhinë, të ndodhur në lagjen “ Partizani ”, pallati nr.647/1, apartamenti nr.17, zona kadastrale 8524, Elbasan.

Tarifat e pagesës së privatizimit do të bëhen në mbështetje të VKM Nr.97 datë 03.02.2008



“ Për procedurat e privatizimit të banesave shtetërore ”.


Llogaritja e koeficientëve për vlerën e banesës dhe të truallit do të merren parasysh të dhënat e paraqitura sipas indeksit dhjetor 1992 dhe indeksi muajit në momentin e nënshkrimit të kontratës së shit-blerjes të këtyre banesave .

- 2) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve, Buxhetit dhe Financës, (Sektori i Strehimit, Privatizimit).
- 3) Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**Klajd GRIPSHI**





111

*[Handwritten signature]*





184  
31.1.2020

REPUBLICA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

79

Nr. 3211 Prot.

Elbasan, më 31.01.2020

VENDIM

Nr. 11 datë 27.01.2020

*"Për rishikimin dhe miratimin e listës së pasurive "pyje", "kullota" dhe "livadhe", që ndodhen brenda territorit administrativ të Bashkisë Elbasan.*

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ .01.2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësor, Veterinar dhe Mjedisit "Për rishikimin dhe miratimin e listës së pasurive "pyje", "kullota" dhe "livadhe", që ndodhen brenda territorit administrativ të Bashkisë Elbasan dhe ndryshimin e VKM nr.433 datë 08.6.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave / Bashkive", në mbështetje te:

- Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar);
- Ligjit nr.9385 datë 04.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" (i ndryshuar);
- Ligjit nr.9693 datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar);
- Ligjit nr.8743 datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" (i ndryshuar);
- Ligjit nr.8744 datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" (i ndryshuar);
- VKM nr.500 datë 14.8.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore" (i ndryshuar);
- VKM nr.360 datë 29.5.2019 "Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo - territorialë të njësive të vetëqeverisjes vendore";
- VKM nr.433 datë 08.6.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave / bashkive";

VENDOSI:

1. Të rishikojë dhe miratojë listën e inventarit për pasuritë "pyje", "kullota" dhe "livadhe", që ndodhen brenda territorit administrativ të Bashkisë Elbasan, sipas listës bashkëlidhur, me numër rendor 1 - 3298.

2. Ti propozojë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit fillimin e procedurave për ndryshimin e VKM nr.433 datë 08.6.2016, për transferimin në pronësi të Bashkisë Elbasan, të pyjeve, kullotave dhe livadheve, sipas listës bashkëlidhur.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës (Sektori i pronave) dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**Klajd Gripshi**

**KRYETARI**

**Hektor Çiftja**

